

# Indeksi i Çmimeve të Importit

## Tremujori II, 2016


**Tiranë, më 07 Shtator:** Në tremujorin e dytë të vitit 2016, Indeksi i Çmimeve të Importit arriti 97,3 % kundrejt vitit 2012. (Viti 2012 = 100).

Në tremujorin e dytë 2016 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Importit është -1,7 %. Indeksi i Çmimeve të Importit në aktivitetet e Industrisë nxjerrëse dhe asaj përpunuese kanë shënuar ulje përkatësisht 6,4% dhe 1,7%.

Në tremujorin e dytë 2016 ndryshimi tremujor i indeksit është 1,0 %. Çmimet e Importit në seksionin "Industria Përpunuese" shënuan rritje me 1,0 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Në këtë seksion vlen të përmendet rritja e çmimeve të produkteve në aktivitetin "Përpunimi i lëkurës" me 3,0 %, "Përpunimi i tekstileve" me 3,1%. Ndërsa çmimet e importit të produkteve në aktivitetet: "Përpunimi i produkteve ushqimore", "Konfeksionimi i veshjeve" shënuan ulje respektivisht me 1,6 % dhe 0,8 %.

Indeksi i Çmimeve të Importit të seksionit "Industria nxjerrëse" kanë pësuar ulje me 6,2 %, ku ulje më të madhe shënon aktiviteti "Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve" me 11,9 %.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit sipas muajve, Janar 2015 – Qershor 2016



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2012=100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	04 - 16	05 - 16	06 - 16	II - 16
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>97,2</b>	<b>97,4</b>	<b>97,2</b>	<b>97,3</b>
<b>B</b>	Industri Nxjerrëse	<b>0,4</b>	<b>93,7</b>	<b>93,7</b>	<b>93,7</b>	<b>93,7</b>
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,2	93,1	93,1	93,1	93,1
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	92,8	92,8	92,8	92,8
<b>C</b>	Industria Përpunuese	<b>95,5</b>	<b>98,1</b>	<b>98,1</b>	<b>98,1</b>	<b>98,1</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,9	93,0	93,1	93,4	93,2
11	Prodhimi i pijeve	2,0	97,5	97,5	97,5	97,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	101,3	101,3	101,3	101,3
13	Përpunimi i tekstileve	5,5	108,7	108,7	108,8	108,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,6	106,7	106,3	105,3	106,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,2	91,8	91,8	91,8	91,8
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	102,7	102,7	102,7	102,7
17	Prodhimi i letres dhe produkteve prej letre	3,0	95,9	96,0	94,8	95,6
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,1	78,4	78,4	78,4	78,4
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,4	92,4	92,7	93,3	92,8
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,7	98,0	98,1	97,7	98,0
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	3,8	103,7	103,7	103,7	103,7
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	98,1	98,1	98,1	98,1
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,2	96,9	96,9	96,9	96,9
24	Metalurgjia	5,2	92,0	92,4	92,0	92,1
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,5	103,5	103,4	103,4	103,4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,0	100,8	100,8	100,8	100,8
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,3	100,0	100,0	99,9	100,0
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	6,9	108,3	108,1	108,4	108,3
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	3,4	106,8	106,8	106,8	106,8
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,6	87,0	87,0	87,0	87,0
31	Prodhimi i mobilie	0,7	97,5	97,5	97,5	97,5
32	Industri të tjera p,k,t	1,6	99,1	99,1	99,1	99,1
<b>D</b>	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	<b>2,8</b>	<b>76,9</b>	<b>79,4</b>	<b>76,6</b>	<b>77,6</b>
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	2,8	76,9	79,4	76,6	77,6
<b>E</b>	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbejtjeve	<b>1,3</b>	<b>81,8</b>	<b>81,8</b>	<b>81,6</b>	<b>81,8</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbejtjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	81,8	81,8	81,6	81,8

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

			%	
NVE	Përshkrimi	Peshat	II-16 / I - 16	II-16 / II-15
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>1,0</b>	<b>-1,7</b>
<b>B</b>	<b>Industri Nxjerrëse</b>	<b>0,4</b>	<b>-6,2</b>	<b>-6,4</b>
05	Nxjerja e qymyrit dhe linjiteve	0,2	-11,9	-8,9
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-1,0	-6,0
<b>C</b>	<b>Industria Përpunuese</b>	<b>95,6</b>	<b>1,0</b>	<b>-1,7</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,9	-1,6	-1,1
11	Prodhimi i pijeve	2,0	1,0	-5,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	0,0	1,6
13	Përpunimi i tekstileve	5,5	3,1	-1,4
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,6	-0,8	4,6
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,2	3,0	3,1
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	0,3	-1,5
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	3,0	1,8	-0,7
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,1	-2,3	-20,0
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,4	3,8	-7,5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,7	1,6	-1,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	3,8	-0,1	-0,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	2,5	1,4
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,2	1,3	0,3
24	Metalurgjia	5,2	-0,2	-6,8
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,5	-0,4	-2,5
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,0	2,0	-2,0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,3	-0,8	1,3
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	6,9	2,6	4,0
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	3,4	-0,3	-2,5
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,6	-1,8	-7,1
31	Prodhimi i mobilie	0,7	-1,3	1,2
32	Industri të tjera p,k,t	1,6	2,4	-0,4
<b>D</b>	<b>Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</b>	<b>2,8</b>	<b>-10,5</b>	<b>-10,2</b>
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	2,8	-10,5	-10,2
<b>E</b>	<b>Fumizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve</b>	<b>1,3</b>	<b>-1,1</b>	<b>-10,2</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	-1,1	-10,2

# Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit është tregues statistikor i cili është pjesë e Programit të Statistikave Zyrtare 2012 – 2016 dhe llogaritja, metodologjia e përdorur mbështeten në Rregulloren e Këshillit Evropian Nr. 1165/98 e datës 19 maj 1998, ndryshuar nga rregullorja e KE-së Nr. 1158/2005 të datës 6 korrik 2005 për Statistikat Afatshkurtra.

**Klasifikimi.** Klasifikimi i përdorur është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Çmimet e importit mbledhen, përpunohen dhe publikohen në bazë të Klasifikimit të Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik (CPA 2008). Produktet janë klasifikuar në nivel 6 shifror sipas NP 2008 (CPA2008) në aktivitetin në të cilin ato janë importuar.

**Njësia e vrojtimit.** Si njësi e vrojtimit për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Importit janë ndërmarrjet ekonomike të cilat importojnë produkte nga tregu i huaj. Vrojtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në aktivitetin e prodhimit dhe tregtisë dhe mbulojnë 80% të vlerës së importeve në aktivitetin ku bëjnë pjesë.

Kryerja e Vrojtimit për Çmimet e Importit ka filluar në vitin 2012. Ky vit është dhe periudha referuese e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇI).

Lista e produkteve dhe e ndërmarrjeve përfaqësuese zgjidhet bazuar në të dhënat e importit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Të dhënat përpunohen dhe llogariten në programin SQL.

Në vitin 2016 u anketuan 620 ndërmarrje të cilat raportojnë 1054 çmime produktesh të importuara.

**Mbledhja e të dhënave.** Të dhënat grumbullohen me vrojtimit tremujor dhe informacioni mbi çmimet e transaksioneve është mujor. Vrojtimi realizohet me intervistim të drejtpërdrejtë. Në pyetësorë janë vetëm produktet më përfaqësuese për ndërmarrjen të cilët kanë një kod gjashtë-shifror sipas NP 2008, përshkrimin e produktit, njësinë matëse, vendin e origjinës.

**Llogaritja e indeksit.** Indeksi i ri i Çmimeve të Importit është indeks zinxhir (me periudhë bazë vitin 2012 = 100). Sipas kësaj metode çmimi i çdo produkti në periudhën korrente (y) krahasohet me çmimin që ai ka pasur në muajin Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1). Treguesi i llogaritur është çmimi relativ i produktit. Çmimet relative peshohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 6 shifror për çdo grup produkti. Indekset elementare në nivel 6 shifror grupohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 2 shifror dhe kështu me radhë deri në llogaritjen përfundimtare të indeksit.

**Çmimi relativ.** Çmimi relativ është raporti i çmimit të produktit në periudhën korrente me çmimin e produktit në dhjetor të vitit të mëparshëm.

**Peshimi.** Mesatarja e peshuar aritmetike e indekseve elementare të produkteve individuale do të formojë indeksin. Indeksi në (short - term - link) për nivelin 6 shifror sipas NVE, Rev.2 është llogaritur duke shumëzuar

çdo peshë të produktit në nivel 6 shifror me çmimin relativ korrespondues dhe duke pjesëtuar shumën e tyre me shumën e peshave.

**Imputimi.** Imputimet bëhen duke shumëzuar çmimin e periudhës së mëparshme me ndryshimin mesatar të çmimeve të produkteve të grupit në të cilin bën pjesë produkti ( në nivelin më të ulët të agregimit 6 ose 2 shifror).

**Formula e llogaritjes.** Për llogaritjen e indeksit është përdorur formula e tipit Laspeyres zinxhir:

$$I_0^t = \frac{\sum_k P_{t;k} Q_{0;k}}{\sum_k P_{0;k} Q_{0;k}} = \sum_k \frac{P_{0;k} Q_{0;k}}{\sum_k P_{0;k} Q_{0;k}} \times \frac{P_{t;k}}{P_{0;k}}$$

ku:

$I_{(t)}$  - indeksi i periudhës t krahasuar me bazën 0 ;

$P_{it}$  - çmimi i artikullit i në periudhën t;

$P_{i0}$  - çmimi i artikullit i në periudhën 0 ;

$Q_{i0}$  - sasia e artikullit i në periudhën 0.

Ky version i formulës së Laspeyres mund të rishkruhet si :

$$I(t) = \sum [W(i) * LTR(i, t-1, 0) * STR(i, t, t-1)]$$

Ku:

LTR (i, t-1, 0) është çmimi relativ ndërmjet periudhës t-1 dhe periudhës 0 dhe

STR (i, t, t-1) është çmimi relativ ndërmjet çmimit të periudhës korent t dhe çmimit të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm.

### Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.